

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

HISTORI DHE SHOQËRI

për klasën e V

Shkup, 2021

TË DHËNAT THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Histori dhe shoqëri</i>
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	I detyrueshëm
Klasa	V (e pestë)
Temat/fushat në programin mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Individi dhe shoqëria</i> • <i>Popullsia dhe kontinentet</i> • <i>Parahistoria dhe historia</i>
Numri i orëve	2 orë në javë/72 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisje digjitale të mençura (smart); • Libër mësimi; • Enciklopedi, fjalorë, atlas gjeografik. • Harta fizike-gjeografike e botës-shkalla 1: 50 000 • Harta politiko-gjeografike e botës. • Paraqitje vizuale të karakteristikave të popullsisë së kontinenteve (ngjyra e lëkurës, tradita etj). • Puzzles me foto të kryeqyteteve të vendeve më të mëdha në botë. • Kalendari për llogaritjen e kohës dhe ilustrime nga kalendarët historikë. • Paraqitje ilustruese e periudhave historike. • Pamje të vendeve arkeologjike në botë dhe vendin tonë. • Shiriti kohor për ngjarjet nga e kaluara, nga parahistoria në të tashmen. • Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. • Fotografitë nga aktivistët e të drejtave të njeriut (Rosa Luksemburg, Martin Luter King dhe Nellson Mandela). • Revista, gazeta, portale interneti, rrjete sociale.

	<ul style="list-style-type: none"> • Përmbajtje audiovizuale të regjistruara, aplikacione, të përshtatshme për moshën. • Burime të tjera të të mësuarit - dukuritë, ngjarjet, objektet në mjedis, në mesin e njerëzve ose në shoqëri (monumentet e kulturës, muzetë, bibliotekat, institucionet kombëtare).
Normativi i kuadrit arsimor	<p>Mësimi nga lënda Historia dhe shoqëria mund të kryhet nga një person që ka titullin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Profesor/mësimdhënës/mësues i mësimit klasor, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK; • Pedagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK.

LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

1. Rezultatet e mësimit të paraqitura në programin mësimor shpiejnë drejt përvetësimit të kompetencave në vijim të përfshira me fushën **Shoqëria dhe kultura demokratike** nga Standardet kombëtare:

	<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është i aftë:</i>
VI-A.1	të shpjegojë se si faktorët shoqërorë ndikojnë mbi personalitetin dhe mjedisin dhe t'i marrë parasysh kur formon opinione dhe kur merr vendime;
VI-A.2	ta analizojë sjelljen e vet në mënyrë që të përmirësohet, duke vendosur qëllime realiste dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;
VI-A.3	t'i formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe t'i trajtojë me respekt edhe kur nuk pajtohet;
VI-A.4	të bëjë reflektime kritike mbi vlerat dhe sjelljet e ndryshme personale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme (veçanërisht në situata të ndjeshme etike), të respektojë normat dhe vlerat e pranuar shoqërore, por edhe t'i sfidojë ato kur ai mendon se është e nevojshme;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo baze (gjinia dhe përkatësia etnike, moshë, aftësitë, statusi shoqëror etj.);
VI-A.6	të njohë praninë e stereotipave dhe paragjykimëve të vetja dhe të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin;
VI-A.7	të njohë manifestimin e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin e vet, t'i perceptojë pasojat e dhunës dhe ta kundërshtojë atë;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i lidh dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjetjë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e ndjeshme në shoqëri, të marrë pjesë në aksione humanitare dhe vullnetare dhe t'i mbështesë ato;

VI-A.11	t'i zbatojë rregullat dhe rregulloret për pjesëmarrje të sigurt në komunikacion;
VI-A.12	t'i analizojë dhe diskutojë në mënyrë kritike vlerat e shoqërisë civile, rolet dhe sjelljet e ndryshme të qytetarëve dhe rolin e tij/saj në të;
VI-A.13	ta analizojë konceptin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, t'i identifikojë rastet e shkeljes së të drejtave dhe të ndërmarrë veprime për respektimin joselektiv të tyre;
VI-A.14	t'i analizojë dhe diskutojë përgjegjësitë e ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit në sundimin e ligjit dhe rolin e shtetit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
VI-A.15	t'i identifikojë situatat në të cilat qytetarët mund të ndikojnë në jetën e komunitetit dhe të angazhohet në përmirësimin e kushteve;
VI-A.16	të njohë situatat e abuzimit me pushtetin, të shpjegojë efektet e dëmshme të korrupsionit tek individ, grupi dhe shoqëria dhe të kundërshtojë fenomene të tilla në mjedis;
VI-A.18	të analizojë në mënyrë kritike kërcënimet nga zhvillimi i pa balancuar mbi mjedisin dhe të kontribuojë në mënyrë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e tij;
VI-A.19	ta shpjegojë rëndësinë e proceseve demokratike në shoqëri dhe të zbatojë parimet e pjesëmarrjes demokratike brenda shkollës;
VI-A.21	të dallojë kuptimin e termave: komb, popull, bashkësi etnike, qytetarë dhe individë; mbi fenomenet: etnike dhe kombësi, patriotizëm dhe nacionalizëm, shumicë dhe pakicë; si dhe konceptet: territori, rajoni, shteti, shoqëria, qeveria, etj. dhe t'i përdorë ato në mënyrë të përshtatshme në kontekste të ndryshme me të cilat lidhen;
VI-A.22	t'i identifikojë dhe respektojë të gjitha simbolet kombëtare të shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të shfaqë ndjenjën e përkatësisë ndaj shtetit;
VI-A.23	t'i identifikojë veçoritë gjeografike të kontinenteve, rajoneve dhe vendeve në botë dhe t'i lidhë ato me zhvillimin e tyre shoqëror;
VI-A.24	t'i identifikojë karakteristikat gjeografike të vendit tonë dhe t'i lidhë ato me zhvillimin shoqëror;
VI-A.25	t'i shpjegojë karakteristikat e mjediseve natyrore dhe shoqërore dhe lidhjen e tyre me organizimin e jetës së njerëzve;
VI-A.27	ta tregojë dhe shpjegojë historinë (sociale, kulturore dhe politike) të popullit tonë dhe historitë e popujve të tjerë që jetojnë në vendin tonë dhe në rajon, me veçoritë e tij dhe në kontekstin e së kaluarës së përbashkët historike;
VI-A.29	t'i identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis feve më të përhapura në botë dhe ateizmit/agnosticizmit, me theks të veçantë në normat dhe vlerat etike që ato përfaqësojnë.
	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
VI-B. 1	nuk guxon të diskriminojë në bazë të dallimeve midis njerëzve (gjinisë dhe përkatësisë etnike, moshës, aftësitë, statusi shoqëror, etj.);
VI-B. 2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;
VI-B.4	respektimi jo-selektiv i të drejtave dhe lirive të njeriut është vendimtar për mirëqenien e individëve dhe të shoqërisë në tërësi;
VI-B.5	barazia dhe kohezioni social janë thelbësore për funksionimin e suksesshëm të komunitetit;

VI-B.6	angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë të rëndësishme për arritjen e interesit të përbashkët publik;
VI-B.7	çdo qytetar është i detyruar të veprojë me përgjegjësi ndaj bashkëqytetarëve të tij, komunitetit dhe shoqërisë në tërësi, duke mbajtur vazhdimisht parasysh pasojat e veprimeve të tij për të tjerët dhe mjedisin;
VI-B.8	çdo qytetar është i detyruar të respektojë ligjet, rregullat dhe rregulloret që rregullojnë sjelljen e njerëzve dhe funksionimin e institucioneve;
VI-B.9	çdo qytetar duhet të marrë përgjegjësinë për ndryshimet në natyrë të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut;
VI-B.11	çdokush ka të drejtë të zgjedhë se cilën fe e konsideron të tij/saj, gjegjësisht të zgjedhë që të mos i përkasë asnjë feje/besimi, pa asnjë pasojë nga zgjedhja e bërë;
VI-B.12	vendi ynë është një shoqëri multikulturore/multietnike e banuar nga pjesëtarë të kulturave/etnive të ndryshme dhe secili prej qytetarëve të tij është përgjegjës për të kontribuar në shkëmbimin ndërkulturor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në interes të jetesës së përbashkët në një shoqëri të integruar, etnikisht kohezive;
VI-B.13	identiteti kombëtar, i cili rrjedh nga përkatësia e shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është një komponent i rëndësishëm i identitetit të të gjithë qytetarëve të shtetit.

2. Programi mësimor, gjithashtu përfshin kompetencat përkatëse në fushat e Standardeve Kombëtare:

Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike, Teknika, teknologjia dhe sipërmarrësia dhe Shprehja artistike dhe kultura.

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe është i/e aftë:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë kur dhe në çfarë mënyre përdorimi i TIK-ut është i nevojshëm dhe efektiv për të zgjidhur një detyrë/problem;
IV-A.3	të përdorë mënyra të ndryshme të organizimit, ruajtjes dhe ndarjes të sigurt të përmbajtjeve në pajisje dhe rrjete të ndryshme në mjedisin digjital;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët të analizojë një problem, të zhvillojë një ide dhe plan për kërkimin dhe zgjidhjen e tij dhe të planifikojë se kur dhe për çfarë do të përdorë TIK-un;
IV-A.5	të përcaktojë se për çfarë informacioni ka nevojë, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna digjitale, informacione dhe përmbajtje;
IV-A.7	të zgjedhë dhe përdorë mjetet e duhura TIK të komunikimit, të ndajë në mënyrë të sigurtë informacionin, të kontaktojë dhe bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, në aktivitete shoqërore ose për nevoja personale;
IV-A.8	të përdorë në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore dhe sociale dhe retë digjitale;
IV-A.9	në komunikim me të tjerët në hapësirën digjitale multikulturore, t'i respektojë pjesëmarrësit e ndryshëm dhe të ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën digjitale;

IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e tij/saj digjital dhe t'i respektojë politikat e privatësisë;
IV-A.12	të hulumtojë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, duke kombinuar paraqitjet statike dhe dinamike, tingullin, tekstin dhe imazhet për të modifikuar ose krijuar produkte të thjeshta krijuese multimediale me një qëllim specifik dhe për një audiencë të veçantë;
IV-A.13	të përcaktojë kriteret e cilësisë për produktet dhe zgjidhjet digjitale, përfshirë inovacionin dhe benefitet;
V-A.3	t'i identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet që ndërtohet në bazë të përkatësisë në grupe të ndryshme sociale (për shembull, gjinisë, identitetin etnik dhe kombëtar) dhe roleve të ndryshme që ai ka në jetë (për shembull, nxënës, djalë/vajzë);
V-A.4	të vlerësojë aftësitë dhe arritjet e tij/saj (përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi këtë bazë të përcaktojë përparësitë që do t'i mundësojnë atij/asaj të zhvillohet dhe të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet tek vetja dhe tek të tjerët, të perceptojë pasojat e reagimeve të veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji të përshtatshme për përballimin e emocioneve;
V-A.6	të vendosë qëllime për mësim dhe vetëzhvillim dhe të punojë për të tejkaluar sfidat që dalin gjatë rrugëtimit drejt arritjeve të tyre;
V-A.7	t'i përdorë përvojat e veta për të lehtësuar mësimin dhe për të rregulluar sjelljen personale në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën e tij/saj në një mënyrë që do t'i mundësojë atij/asaj të arrijë në mënyrë efikase dhe efektive qëllimet e përcaktuara dhe të plotësojë nevojat e tij/saj;
V-A.9	t'i parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të të tjerëve për veten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike në vlerësimin e të drejtës dhe të gabuarës në veprimet e veta dhe të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtutshme të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetë disiplina);
V-A.11	të veprojë në mënyrë të pavarur, me vetëdije të plotë se kujt, kur dhe si mund të kërkojë ndihmë;
V-A.12	të përballojë me sukses presionet sociale;
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të paraqitet në mënyrë të përshtatshme për situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në një mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.16	të njohë problemet në marrëdhëniet me të tjerët dhe të afrohet në mënyrë konstruktive në zgjidhjen e konflikteve, duke respektuar të drejtat, nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira;
V-A.17	të kërkojë informatë kthyesë dhe mbështetje për veten, por gjithashtu ta kthejë informatën në mënyrë konstruktive dhe mbështetëse në dobi të të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë, të bëjë pyetje relevante në mënyrë që t'i identifikojë problemet, t'i analizojë dhe vlerësojë informacionet dhe

	sugjerimet dhe t'i verifikojë supozimet;
V-A.19	të propozojë, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat në mënyrë që të nxjerrë konkluzione dhe të marrë vendime racionale;
V-A.21	ta analizojë, vlerësojë dhe përmirësojë të mësuarit e vet;
VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe me respekt të vazhdueshëm të rolit dhe kontributit të të gjithë anëtarëve të ekipit;
VIII-A.3	t'i shpreh idetë, përvojat dhe emocionet personale, duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive);
VIII-A.5	të manifestojë njohuri për kulturën e vet dhe për mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve pamore, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe produkteve të tjera kulturore;
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e vet më të ngushtë dhe më të gjerë dhe të analizojë lidhjen dhe ndërvarësinë e tyre;
VIII-A.7	të njohë dhe shpjegojë se si monumentet kulturore ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në kontekste të ndryshme;
VIII-A.10	t'i identifikojë dhe rishqyrtojë stereotipat dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që shfaqen në mjedisin e tij/saj;
VIII-A.12	ta interpretojë botën jo vetëm nga pikëpamja e anëtarëve të kulturës personale, por edhe nga perspektiva e kulturave të tjera.
<i>Nxënësi/nxënësjka kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme – lehtëson të nxënit, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm i TIK -ut ka kufizime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose shoqërinë;
IV-B.3	potenciali i TIK do të rritet dhe duhet të monitorohet dhe përdoret, por gjithashtu që duhet të ketë një qëndrim kritik ndaj besueshmërisë, konfidencialitetit dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm nëpërmjet pajisjeve digjitale;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, privatësisë dhe sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes dhe ngacmimi kibernetik dhe të respektohen rregullat dhe normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacioni i disponueshëm në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;
V-B.2	njohja e identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia personale kryesisht varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që ai/ajo arrin;

V-B.4	çdo veprim që ai/ajo ndërmerr ka pasoja për të dhe/ose mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	bashkëveprimi me të tjerët është i dyanshëm - siç ka të drejtë t'i kërkojë nga të tjerët që t'i mundësojnë atij/asaj që të jetë i kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/saj, ashtu edhe ai/ajo ka përgjegjësinë t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informatave kthyesë dhe pranimi i kritikës konstruktive shpiejnë në përparim personal në nivel individual dhe shoqëror;
VII-B.4	etika e punës, ndjeshmëria kulturore dhe qëndrimi ndaj të tjerëve janë të rëndësishme për krijimin dhe ruajtjen e një klime pozitive pune;
VII-B.5	resurset nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi;
VIII-B.3	respektimi dhe promovimi i kulturës së vet kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor;
VIII-B.4	diversiteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të anëtarëve të kulturave të ndryshme;
VIII-B.5	dallimet ndërkulturore duhet të shihen si një mundësi për të mësuar dhe një sfidë për mirëkuptimin dhe përparimin reciprok;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit për kulturën e vet nga të tjerët.

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: **INDIVIDI DHE SHOQËRIA**

Gjithsej: **29 orë**

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. bëjë dallim midis veprave të këqija, padrejtësive dhe gënjeshtreve kundrejt sjelljes morale/të mirë;
2. identifikojë faktorët e socializimit dhe shpjegojë se si ndikojnë në formimin e personalitetit;
3. të bëjë dallim ndërmjet përkatësisë etnike dhe shtetërore/kombëtare dhe të shpjegojë se si përkatësia në këto dhe grupe të tjera shoqërore përcakton identitetin e çdo individi;
4. shpjegojë parimet bazë të të drejtave të njeriut, të lidh të drejtat me përgjegjësitë dhe të njohë situatat e shkeljes së të drejtave të fëmijës në jetën e përditshme.

Nxënësi/nxënësja do të zhvillojë:

1. qëndrim pozitiv ndaj përkatësisë kombëtare/shtetërore;
2. qëndrim kritik ndaj pabarazisë, diskriminimit dhe racizmit;
3. ndërgjegjësim për nevojën e respektimit të të drejtave të fëmijës.

Përmbajtjet (dhe konceptet)

- Vlerat etike (ndershmëria, e vërteta, drejtësia, gënjeshtria, shantazhi, ryshfeti, shpifja, padrejtësia)
- Socializimi (normat shoqërore, personaliteti, faktorët e socializimit)

Standardet për vlerësim

- Jep shembuj të sjelljes joetike (gënjeshtria, shantazh, ryshfet, shpifje, padrejtësi);
- Shpjegon nevojën e respektimit të vlerave etike (ndershmëria, e vërteta, drejtësia);
- Argumenton duke dënuar padrejtësinë e bërë;
- Shpjegon socializimin si një proces nëpërmjet të cilit fëmijët mësojnë se si të bëhen anëtarë të shoqërisë;
- Shpjegon rolin e normave shoqërore (sociale) në jetën e njerëzve;
- Jep shembuj nga realiteti që shpjegon rolin e familjes, shkollës, bashkëmoshatarëve/miqve dhe medias në procesin e socializimit;

<ul style="list-style-type: none"> • Përkatësia në grupe të ndryshme (grupi shoqëror/social, identiteti, përkatësia kombëtare/shtetërore, etnia, qytetarët) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rolin e socializimit në formimin e personalitetit; • Shpjegon (nëpërmjet shembujve) se si përkatësia në grupe të ndryshme shoqërore përcakton identitetin e çdo individi; • Shpjegon (me shembull) dallimin ndërmjet kombësisë/shtetit dhe etnisë. • Shpjegon rolin e qytetarëve që lind nga përkatësia ndaj shtetit duke treguar se si tregohet respekti për shtetin e vet;
<ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat e njeriut (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, të drejtat e njeriut, liria, parimet e universalitetit, patjetërsueshmëria, barazia dhe mosdiskriminimi, diskriminimi, Rosa Luksemburg, Martin Luter King) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon, me shembull, se të drejtat themelore të njeriut burojnë nga nevojat e njerëzve për mbijetesë, zhvillim dhe përparim në shoqëri. • Tregon kur dhe ku është miratuar Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe shpjegon pse; • Shpjegon, nëpërmjet shembujve, parimet bazë të të drejtave të njeriut (universaliteti, patjetërsueshmëria, barazia dhe mosdiskriminimi); • Njih diskriminimin e bazuar në dallimet mes njerëzve; • Shpjegon rolin e Rosa Luksemburgut në luftën për të drejtat e grave; • Shpjegon përfitimet për njerëzimin nga lufta e Martin Luter King për barazi dhe mosdiskriminim;
<ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat e fëmijës (Konventa për të drejtat e fëmijës, të drejtat e mbijetesës, të drejtat e zhvillimit, të drejtat e mbrojtjes, të drejtat e pjesëmarrjes, përgjegjësia) 	<ul style="list-style-type: none"> • Bën dallime ndërmjet grupeve për të drejtat e fëmijëve (mbijetesë, zhvillimi, mbrojtja dhe pjesëmarrja); • Shpjegon pse të drejtat e fëmijës janë të veçanta në raport me të drejtat e njeriut; • Lidh të drejtat me përgjegjësitë; • Njih situatat e shkeljes së të drejtave të veta dhe të drejtave të të tjerëve.
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi përgatit tregime të sjelljes me shembuj të gënjeshtres (për shembull: një fëmijë i kërkon tjetrit para për një sanduiç të cilin më pas i shpenzon duke luajtur videolojëra), për shpifje (për shembull: një fëmijë i thotë një fëmije tjetër se i ka vjedhur diçka në shitore edhe pse nuk e ka bërë këtë për të dëmtuar reputacionin e tij), për ryshfet (për shembull: një fëmijë i jep para një tjetri për të fshehur se ka thyer një dritare) dhe për shantazh (për shembull: një fëmijë kërkon para nga një tjetër për të mos u thënë të tjerëve se ka thyer dritaren). Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një tregim për të identifikuar sjelljen e pandershme dhe për të renditur karakteristikat e fëmijëve që veprojnë në mënyrë të pandershme (të pandershëm dhe gënjeshtarë) dhe fëmijëve që nuk veprojnë (të ndershëm dhe të vërtetë). Secili grup paraqet tregimin dhe analizën e bërë. Së fundi, ata diskutojnë pasojat e një sjelljeje të tillë tek fëmijët që gënjajnë / shpifin / ryshfet / 	

shantazhojnë, tek fëmijët të cilëve u drejtohet një sjellje e tillë dhe në marrëdhëniet e tyre. Zakonisht arrihet në përfundimin se pse vlerat etike janë të rëndësishme për ndërtimin e marrëdhënieve të besimit të ndërsjellë midis fëmijëve dhe të rriturve;

- Nxënësit, të ndarë në grupe, interpretojnë situata (një në grup) që tregojnë praktika joetike, si gënjeshtër, shantazhe, ryshfet, shpifje dhe padrejtësi që përfshijnë të rriturit (mund të përdoren situata të përshtatura nga aktiviteti i mëparshëm). Për çdo situatë ata përgatisin një video të shkurtër, komentojnë procedurën joetike që paraqitet dhe nga të gjitha videot së bashku bëjnë një video më të gjatë që e shfaqin para të tjerëve në shkollë ose e postojnë në faqen e Facebook /ueb faqen, /klasës;
- Nxënësit, të ndarë në grupe, ndajnë përvojat e tyre ose të bashkëmoshatarëve të tyre për padrejtësinë e përjetuar në shkollë. Më pas ata zgjedhin një nga situatat e paraqitura të padrejtësisë për të cilën duhet të shkruajnë një letër proteste ose ankesë drejtuar kryetarit të bashkësisë së klasës, kryetarit të bashkësisë së nxënësve, avokatit të popullit i nxënësve, mësimdhënësit të klasës, shërbimi profesionist ose drejtorit. Në letër/ankesë ata duhet të përshkruajnë shkurt situatën e padrejtësisë, të argumentojnë pse është padrejtësi dhe të kërkojnë marrjen e masave. Pasi secili grup të ketë lexuar letrën/ankesën, diskutohet se çfarë është padrejtësia, kujt t'i drejtohet kur ndodh padrejtësia dhe si mund të mbrohen;
- Detyrë projektuese. Një grup nxënësish me ndihmën e mësimdhënësit përgatit një pyetësor me të cilin do të anketojë nxënësit e shkollës për të zbuluar praninë e gënjeshtërës, shantazhit, ryshfetit, shpifjes dhe padrejtësisë tek nxënësit (shembuj pyetjesh: A keni gënjer shokët tuaj të klasës më shumë se 10 herë gjatë javës së kaluar?; A ju kanë gënjer shokët e klasës më shumë se 10 herë gjatë javës së kaluar?; A jeni shantazhuar nga shokët e klasës për diçka gjatë këtij viti?). Rezultatet e marra i paraqesin në tabelë (ose grafik) dhe së bashku me përfundimin që përshkruan gjendjen në shkollë i publikojnë në tabelën e shpalljeve në shkollë;
- Nxënësit përgatiten për "protesta". Të ndarë në grupe, ata dalin me slogane të shkurtra për të ndihmuar në luftën kundër gënjeshtërës, shantazhit, ryshfetit, shpifjes dhe padrejtësisë (për shembull: *Bëhu një lojtar i drejtë!; Respekto të tjerët!; Kush gënjen, vjedh!; Shantazhuesit në burg! Raportoni ryshfetin! Shpifja është armiku më i madh!*). Çdo parollë shkruhet në një copë letre të veçantë. Më pas ata ecin nëpër klasë, duke simuluar një protestë - i mbajnë parullat me zë të lartë dhe i bërtasin me zë të lartë;
- Përgatiten gjashtë fletë në të cilat shkruhet njëra nga fjalët e mëposhtme: 1) nxënës, 2) prind, 3) fqinj, 4) shoku, 5) mjek dhe 6) punonjës policie. Nxënësit ndahen në gjashtë grupe dhe secili grup vizaton një fletë me detyrën që të përgjigjet: Çfarë sjellje pritet nga ...? Përgjigjet duhet t'i referohen asaj që shkruhet në fletën e vizatuar. Grupet shkruajnë përgjigjet e tyre dhe ia paraqesin të gjithëve. Më pas atyre u jepet një detyrë e re - nxënësit, brenda grupit, duhet t'i përgjigjen pyetjes se si e dinë si duhet të sillen nxënësit, prindërit, fqinjët, miqtë, mjekët dhe punonjësit e policisë. Së fundi, bëhet një diskutim i hapur për të konkluduar se: a) sjellja e prishme lind nga rregullat e përcaktuara nga shoqëria, b) ato rregulla quhen norma shoqërore, c) normat shoqërore mësohen gjatë socializimit dhe d) socializimi është një proces me anë të të cilit fëmijët mësojnë si të bëhen anëtarë të shoqërisë;
- Nxënësit ndahen në katër grupe dhe përgatiten për debat. Secili grup punon për një nga faktorët e socializimit: familjen, miqtë (moshataret), shkollën dhe median. Duke vepruar kështu, ai sajton sa më shumë argumente, të mbështetura me shembuj nga realiteti, me të cilat duhet t'u dëshmojë të tjerëve se faktori "i tyre" është më i rëndësishmi për atë që fëmijët do të mësojnë se është mirë/keq që bëjnë dhe si ata do të sillen. Grupet më pas thonë në mënyrë alternative një argument me një shembull, çdo herë të përfaqësuar nga një anëtar i ndryshëm i

grupit. Të gjithë e nisin argumentin e tyre me fjalinë: Familja / shkolla / miqtë / media (në varësi të grupit ku bëjnë pjesë) është më e rëndësishmja për socializim sepse ... dhe ata japin një argument të ndjekur nga një shembull. Së fundi, në një diskutim të hapur, arrihet në përfundimin se çdo faktor është i rëndësishëm dhe ka një ndikim të ndryshëm në periudha të ndryshme të fëmijërisë. Theksohet se në procesin e socializimit fëmijët mund të mësojnë të respektojnë vlerat etike, por edhe të mos i respektojnë ato, në varësi të asaj që kanë mësuar nën ndikimin e mjedisit të tyre (faktorët e socializimit);

- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, marrin një fletë pune në qendër të së cilës vizatohet një rreth që thotë PERSONALITET: sjellje ndaj njerëzve të tjerë dhe punës dhe rreth tij vizatohen disa rrathë bosh. Detyra e grupeve është të tregojnë në rrathët boshe tipare të ndryshme të personalitetit nëpërmjet të cilave manifestohen mënyra të ndryshme të sjelljes së një personi ndaj njerëzve të tjerë dhe / ose punës (shembull: bashkëpunues /bashkëpunuese - bashkëpunon me kolegët; i përpiktë/e përpiktë - plotëson detyrat me kohë). Theksohet se tiparet nuk duhet të shkruhen vetëm në gjininë mashkullore, por duhet të shkruhen edhe në gjininë femërore (shembull: bashkëpunues/bashkëpunuese). Pas prezantimit të punës së bërë, grupeve u jepet një detyrë e re - këtë herë për të diskutuar pse individët ndryshojnë në karakteristikat e tyre dhe në mënyrën se si i trajtojnë të tjerët dhe punojnë (shembull: pse disa janë më bashkëpunues se të tjerët, më të zellshëm se të tjerët) . Së fundi, bëhet një diskutim i hapur për të konkluduar se personaliteti formohet gjatë socializimit dhe shumica e tipareve të personalitetit që manifestohen në sjelljen ndaj të tjerëve dhe në punë mësohen nën ndikimin e familjes, shkollës, bashkëmoshatarëve dhe mediave;
- Mësimdhënësi shkruan në tabelë fjalitë me të cilat ai/ajo e përshkruan veten duke përdorur elementet e mëposhtme: 1) gjinia, 2) familjarët, 3) profesioni, 4) shkolla ku punon, 5) përkatësia etnike dhe 6) përkatësia kombëtare/shtetërore. Nxënësit marrin një fletë pune me fjali të papërfunduara për të plotësuar, duke përdorur si model prezantimin e mësuesit:

Unë jam _____. (Tregon: djaë ose vajzë.)

Familjen time e përbëjnë _____.

Unë jam nxënës në klasën e _____. (Tregon klasën.)

Mësoj në shkollën filllore _____.

Unë jam _____. (Tregon grupin etnik.)

Unë jam nga _____. (Tregon emrin e shtetit.)

Pas përfundimit të detyrës, mësimdhënësi fton nxënësit që i përkasin të njëjtit grup (sipas shumicës së elementeve në përshkrim) të ngrihen në këmbë ose të vendosen në pjesë të ndryshme të klasës. Grupet janë: 1) djem dhe vajza, 2) nxënës të klasës së caktuar 3) nxënës në shkollën e caktuar, 4) pjesëtarë të secilit grup etnik të përfaqësuar veç e veç dhe 5) qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pastaj bëhet një diskutim i hapur për të arritur në përfundimin se ka ngjashmëri dhe dallime midis njerëzve në përkatësinë në grupe (shembull: përkatësia në një familje të caktuar ndahet nga një numër i vogël njerëzish, që i përkasin një klasë të caktuar më shumë, në një shkollë të caktuar edhe më shumë, për një profesion të caktuar më shumë, për një grup të caktuar etnik akoma më shumë, për një vend të caktuar akoma më shumë, dhe për një gjini/lloj të caktuar më shumë) dhe se përkatësia e grupeve përcakton identitetin e tyre (shembull nuk është njësoj nëse një nxënës është në klasën e tretë apo të pestë / shkollën filllore apo të mesme, nëse punon si mësues klase apo si oficer policie), nga e cila varet më tej

qëndrimi i tyre ndaj grupeve të ndryshme - njerëzit ndihen më të lidhur me anëtarët e grupeve të cilëve u përkasin se sa të tjerëve (për shembull: prindërit i mbrojnë fëmijët e tyre më shumë se të tjerët, gratë solidarizohen lehtësisht kur sulmohen për diçka nga burrat);

- Nxënësve, të ndarë në grupe, u kërkohet të shkruajnë atë që dinë për gjuhën, gatimet/ ëmbëlsirat tradicionale, muzikën popullore dhe fenë mbizotëruese të grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kur mbarojnë, para të gjithëve paraqesin atë që është shkruar, duke plotësuar njëri-tjetrin. Nëse nuk kanë njohuri për grupet e ndryshme etnike, mësuesi i prezanton nëpërmjet një prezantimi të përgatitur më parë. Të njëjtat grupe nxënësish më pas u jepet detyrë të vizatojnë flamurin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në një fletë të veçantë, dhe nga ana tjetër të deklarojnë se çfarë i bën ata krenarë që janë qytetarë të vendit (për shembull: karakteri multietnik, bukuritë natyrore, disa tipare të përbashkëta të qytetarëve, si: mikpritja, solidariteti...). Pasi të kenë mbaruar, ua prezantojnë të gjithëve atë që është shkruar, kështu që në diskutim konstatohet se qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndryshojnë sipas përkatësisë etnike, por ndajnë të njëjtën shtet, përkatësisht përkatësi kombëtare;
- Mësimdhënësi përgatit dy fletë të mëdha letre (ndoshta nga një tabelë flipchart). Në krye të njëres thuhet: *Shteti i Republikës së Maqedonisë së Veriut i respekton qytetarët e vet nëse u siguron atyre: ...*, dhe në anën tjetër: *Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut respektojnë vendin e tyre duke: ...* Nxënësit, të ndarë në grupe, japin përgjigje për të dyja pyetjet. Më pas ata i shkruajnë përgjigjet e tyre në fletët e mëdha në mënyrë që grupet të renditin në mënyrë alternative një përgjigje në secilën fletë dhe një në fletën tjetër. Për përgjigjet e përsëritura, grupet vendosin një shenjë të veçantë (për shembull: një yll). Në fund, mësimdhënësi lexon atë që shkruhet në fletë dhe përmbledh se shteti respekton qytetarët e tij (për shembull: u siguron atyre arsimim, trajtim, të folur në gjuhën amtare, mundësi punësimi, energji elektrike dhe ujë) dhe se ata respektojnë shtetin (për shembull: respektojnë simbolet e shtetit, ligjet, ndihmojnë bashkëqytetarët e tyre);
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr një komplet prej njëzet kartelash të shkruara (dhe mundësisht të ilustruara) dhe disa kartela bosh - secila prej kartelave të shkruara paraqet një nevojë (shembull: ajër i pastër, arsim, ushqim të shëndetshëm, kujdes shëndetësor) ose një dëshirë (shembull: dhomë të veten, kompjuter, biçikletë, para xhepi). Detyra e tyre e parë është të shikojnë kartelat dhe nëse mendojnë se diçka mungon që ata duan dhe që është shumë e rëndësishme për ta, ta shkruajnë atë (dhe vizatojnë) në kartelat bosh. Pasi të kenë përfunduar kartelat, atyre u kërkohet të lënë mënjanë tetë kartela nga të cilat mund të heqin dorë nëse duhet. Pasi mësimdhënësi ka mbledhur kartelat që kanë hequr dorë, ata u kërkojnë grupeve të heqin dorë nga tetë të tjera. Secili grup ngjit kartelat e mbetura në një copë letër dhe ua paraqet të tjerëve. Mësimdhënësi, së bashku me nxënësit, shënon se cilat gjëra përsëriten në të gjitha grupet dhe më pas diskuton se cilat gjëra janë më të lehta për t'u hequr dorë, cilat janë më të vështira dhe pse. Mësimdhënësi tregon nëse dëshirat dhe nevojat janë paraqitur në kartela dhe bashkërisht arrihet në përfundimin nëse ato që janë mbajtur janë nevoja apo dëshira. Mësimdhënësi më pas thekson se nevojat janë zakonisht gjëra pa të cilat mbijetesa, zhvillimi dhe përparimi në shoqëri janë të pamundura dhe se të drejtat e njeriut burojnë prej tyre;
- Mësimdhënësi shpjegon të drejtat e njeriut si një sistem rregullash për të cilat njerëzit kanë rënë dakord në nivel ndërkombëtar dhe paraqet se çfarë është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, kur dhe ku është miratuar dhe cila ka qenë arsyeja e miratimit të saj. Nxënësit, të ndarë në dyshe, i përgjigjen një kuizi me një duzinë pohime - përcaktojnë nëse pohimi i dhënë është i vërtetë (S) apo i pasaktë (P).

Pretendimet kanë të bëjnë me parimet bazë të të drejtave të njeriut: universalitetin dhe patjetërsueshmërinë (për shembull: *Të drejtat e njeriut vlejné vetém për qytetarët e vendeve të pasura.–P; Refugjatët kanë të njëjtat të drejta njerëzore si qytetarët e tjerë.–S; Të drejtat e njeriut i përkasin çdo njeriu që nga lindja.–S; Të drejtat e njeriut mund t'u hiqen njerëzve që nuk i meritojnë ato.) P), barazia dhe mosdiskriminimi (Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta.–S; Askush nuk duhet të diskriminohet në bazë të gjinisë, racës, etnisë, fesë, moshës, origjinës, aftësisë së kufizuar ose statusi social.–S; Burrat justifikohen të fitojnë më shumë se gratë.–P; Njerëzit që nuk pajtohen duhet të ndalohen të flasin në televizion.–P). Përgjigjet e nxënësve përdoren në diskutim për të shpjeguar secilin nga parimet e mësipërme dhe për të mbështetur shpjegimin me shembuj nga jeta e përditshme (p.sh.: *Vajzat nuk duhet të ndalohen të luajnë futboll sepse janë vajza*);*

- Mësimdhënësi njofton se të gjitha vajzat e klasës do të luajnë një lojë interesante dhe të gjithë djemtë do të duhet të ulen në karrige, do të heshtin dhe nuk do të bëjnë asgjë gjatë lojës. Vajzat ndahen në grupe prej 5 deri në 6 pjesëmarrëse dhe formojnë "vemjet": ato rreshtohen në kolona, duke mbajtur supet nga pas. I pari në kolonë ("koka vemje") duhet të gjuajë "bishtin", ndërsa "trupi i vemjes" duhet të lëvizë majtas dhe djathtas për ta parandaluar. Kur "koka" kap "bishtin", shkon në vendin e vet (bëhet "bisht"), dhe nxënësi pas saj bëhet "kokë". Aktiviteti zgjat rreth 5 minuta dhe djemtë bëjnë kujdes që të mos marrin pjesë në asnjë mënyrë. Në fund të lojës, diskutohet se si ishte për ata që luajtën dhe si për ata që nuk morrën pjesë dhe sa e drejtë është të zgjedhësh të marrësh pjesë disa nga nxënësit vetëm sepse janë vajza. Zakonisht arrihet në përfundimin se nuk është aspak e drejtë të trajtohen njerëzit ndryshe për shkak të tipareve që nuk kanë të bëjnë fare me aktivitetin për të cilin ata janë zgjedhur. Mësimdhënësi thekson se një veprim i tillë quhet diskriminim - sa herë që disa njerëzve u lejohej diçka që është e ndaluar për të tjerët, pa ndonjë arsye reale për këtë, shkelet parimi i barazisë dhe bëhet diskriminim. Në fund, nxënësve u kërkohet të tregojnë situata të tjera nga jeta e përditshme kur anëtarët e grupeve të ndryshme trajtoheshin ndryshe edhe pse nuk ka asnjë arsye reale për këtë;
- Nxënësit ndahen në grupe. Gjysma e grupeve kanë për detyrë të paraqesin kontributin e Rosa Luksemburgut në luftën për të drejtat e grave dhe gjysma tjetër me kontributin e Martin Luther King Jr. në luftën për barazi dhe mosdiskriminim. Pas kërkimeve në internet (ueb faqe të mundshme: <https://okno.mk/node/25122> ; <https://akademik.mk/megjunaroden-den-na-zhenata-pravata-na-zhenite-se-nerazdeliv-del-od-univerzalnite-chovekovi-prava/> ; <https://mk.voanews.com/a/who-was-martin-luther-king/4752610.html>) secili grup përgatit një prezantim të shkurtër multimedial për aktivistin "e tyre" të të drejtave të njeriut me disa foto dhe 5 fjali, në të cilat përveç të dhënave bazë biografike, ai/ajo liston përpjekjet e tij/saj, gjegjësisht kontributin e tij/saj. Secili nga grupet që punon për kontributin e Rosa Luksemburg përgatit 5 slogane të destinuara për një protestë kundër diskriminimit ndaj grave, të cilat më pas simulojnë një protestë në klasë, dhe secili nga grupet që punon për kontributin e Martin Luter King përgatit një fjalim me 5 fjali më të gjata kundër pabarazisë dhe diskriminimit, të cilat më pas lexohen në podium, me diksionin e duhur dhe komunikimin joverbal;
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr një sërë kartelash për të drejtat e fëmijëve që do të ndahen në katër grupe të veçanta: mbijetesa (shembull: e drejta për jetë, liri dhe siguri, e drejta për familje, e drejta për sigurim shoqëror, e drejta për kujdes shëndetësor dhe mjekësor), zhvillimi (shembull: e drejta për arsimim, e drejta për arsim cilësor, e drejta për pushim dhe kohë të lirë, e drejta për identitetin e dikujt, e drejta për të përdorur gjuhën e vet), mbrojtja (shembull: e drejta për privatësi, prezumimi i pafajësisë, përveç nëse provohet

ndryshe, mbrojtja kundër shfrytëzimit, mbrojtja kundër përdorimit të drogës, mbrojtja nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, mbrojtja nga ngacmimi dhe neglizhenca, ndalimi i skllavërisë) dhe pjesëmarrje (shembull: e drejta për mendimin e dikujt, lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion, lirinë e tubimit dhe shoqërimit, lirinë e besimit dhe fesë). Mësimdhënësi paraqet se cilat të drejta i përkasin cilit grup dhe nxënësit krahasojnë nëse i kanë renditur saktë kartelat. Bashkarisht konstatojnë se përse secila nga të drejtat i takon grupit të përmendur. Më pas bëhet një diskutim (me shpjegime) për pyetjet: A i kanë të rriturit këto të drejta apo vlejnë vetëm për fëmijët?; A kanë fëmijët më pak të drejta se të rriturit? A mund të luftojnë vetë fëmijët për respektimin e të drejtave të tyre? Konstatohet se fëmijët kanë të njëjtat të drejta si të rriturit (sipas parimit të universalitetit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut), por janë më të cenueshëm se të rriturit (më të rrezikuar) për shkak të të cilave mënyra e ushtrimit të të drejtave të tyre është e ndryshme. Së fundi, mësimdhënësi tregon për Konventën e vitit 1989 për të Drejtat e Fëmijëve, e cila u miratua për të rregulluar specifikat e të drejtave të fëmijëve;

- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup zgjedh një fletë në të cilën shkruhet një kombinim i tre të drejtave (nga të mëposhtmet: e drejta për privatësi, e drejta për pushim dhe kohë të lirë, e drejta për kujdes shëndetësor, e drejta për mbrojtje nga dhuna, e drejta për arsimim, e drejta për arsim cilësor, e drejta e mendimit personal, liria e shprehjes, e drejta e aksesit në informacion, e drejta e mbrojtjes kundër shfrytëzimit dhe abuzimit seksual). Për secilën nga të drejtat në fletë, grupi shkruan se si duhet ta ushtrojnë fëmijët këtë të drejtë në kontekstin e shtëpisë dhe të shkollës (shembull i së drejtës për privatësi në kontekstin e shtëpisë:—*Mos hyni në dhomën e fëmijëve pa trokitur në derë.*—*Mos i lexoni mesazhet nga celulari.*; në kontekstin e shkollës:—*Mos gërmoni në çantën e shpinës së dikujt pa leje.*—*Mos kërkoni shpjegim para të gjithëve për mungesën nga mësimi.*). Në këtë mënyrë mësimdhënësi shkruan në tabelë modelin që duhet ndjekur:

Pasi kam të drejtë të.../liri të, askush në shtëpi nuk guxon....

Pasi kam të drejtë të.../liri të/askush në shkollë nuk guxon.....

Pas prezantimit të punës së bërë (njëra pas tjetrës), bashkërisht arrihet në përfundimin se në jetën e përditshme secila e drejtë praktikohet në mënyra të ndryshme.

- Nxënësit, të ndarë në dyshe, marrin një fletë pune me të paktën 5 të drejta të fëmijëve të shkruara në të. Detyra e tyre është të riformulojnë të drejtën e deklaruar duke shkruar një mënyrë për ta ushtruar atë të drejtë nga ana e tyre, duke filluar me shprehjen kam të drejtë ... ose kam liri ... dhe nën të do të formulojnë dhe shkruajnë përgjegjësinë lidhur me këtë të drejtë që lind nga nevoja për të mos penguar ushtrimin e asaj të drejte. Duke vepruar kështu, ata duhet të zbatojnë shembullin që mësimdhënësi shkruan në tabelë:

E drejta për shkollim cilësor.

Kam të drejtë të kërkoj të kem mësimdhënës që do të më shpjegojnë që të mësoj.

Unë kam përgjegjësi që të mos shqetësoj mësimdhënësit në mësimdhënie dhe nxënësit e tjerë në mësim.

Pas prezantimit të punës së grupeve diskutohet se çfarë nënkuptojnë përgjegjësitë që kanë të bëjnë me të drejtat dhe arrihet në përfundimin se gjatë ushtrimit të secilës së drejtë duhet të merren parasysh kufizimet në sjelljen e tij që pengojnë praktikimin e asaj të drejte por edhe praktikimin e kësaj të drejte nga të tjerët;

- Nxënësit, të ndarë në grupe, bazohen në një situatë në të cilën është përshkruar një shkelje e një ose më shumë të drejtave të fëmijës (për shembull: një situatë në të cilën një nxënëse hartimin me shkrim ka marrë një notë më të ulët se sa mendon se e meriton dhe kërkon informatë kthyesë nga mësuesja, e cila në vend që t'i shpjegojë se ku ka gabuar dhe si të përmirësohet, i thotë vetëm se nota është rezultat i një teme të gabuar dhe se ajo nuk ka të drejtë të kundërshtojë notën). Grupet kanë për detyrë të nënvizojnë përshkrimet në situatë që tregojnë shkelje të të drejtave të fëmijës dhe të identifikojnë të drejtat që janë shkelur (p.sh.: e drejta për arsim cilësor, e drejta për mendim personal, e drejta për të aksesuar informacionin). Secili grup do të paraqesë situatën "e tyre" dhe do të tregojë të drejtat që janë shkelur në të, me një shpjegim se ku mund të shihet kjo. Më pas mësuesja fillon një diskutim të nxitur nga pyetjet/kërkesat e mëposhtme: Rendisni situatën nga përvoja juaj në të cilat të drejtat tuaja ose të drejtat e një fëmije tjetër (shokut tuaj dhe/ose shokut të klasës) janë shkelur!; Cilat të drejta janë shkelur? Si?.

Tema: **POPULLSIA DHE KONTINENTET**

Gjithsej: **18 orë**

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë të:

- shpjegojë se si zbulimet e mëdha gjeografike kanë kontribuar në përhapjen e popullsisë nga një kontinent në tjetrin;
- rendisë kontinentet sipas madhësisë, popullsisë dhe dendësisë së popullsisë dhe të dallojë kontinentin me popullsinë më të dendur dhe kontinentin me numër më të madh të popullsisë;
- bëjë dallimin ndërmjet natalitetit, vdekshmërisë (mortalitetit) dhe shtimit natyror të popullsisë;
- shpjegojë strukturën dhe lëvizjen e popullsisë në botë;
- rendisë vendet më të mëdha në çdo kontinent (sipas sipërfaqes dhe popullsisë) dhe kryeqytetet e tyre dhe i tregon në hartë gjeografike;
- përshkruajë Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas vendndodhjes së saj (Evropa dhe Gadishulli Ballkanik), sipërfaqes, popullsisë dhe dendësisë së popullsisë.

Pëmbajtjet (dhe konceptet)

- Përhapja e popullsisë në Tokë
- Zbulime të mëdha gjeografike
- (Kristofer Kollumbo, Vasko de Gama, Fernando Magelan, Xhejms Kuk)

Standardet për vlerësim

- Tregon ku dhe kur u shfaqën njerëzit e parë;
- Shpjegon se si u zhvillua dhe u përhap popullsia në Tokë;
- Shpjegon ndryshimin midis zonave të përhershme të banuara, të banuara përkohësisht dhe përgjithësisht zona të pabanuara në Tokë;
- Tregon zbulimet e kontinenteve (kur dhe si janë zbuluar);
- Lidh zbulimin e kontinenteve me përhapjen e popullsisë në Tokë.
- Krahason kontinentet sipas popullsisë dhe i rendit nga më i madhi tek më i vogli sipas popullsisë;

- Popullsia botërore

<p>(sipërfaqja, popullsia, dendësia e popullsisë, nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror, migrimi, ngjyra e lëkurës, feja)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason kontinentet sipas sipërfaqes dhe i rendit nga më i madhi tek më i vogli sipas sipërfaqes; • Krahason kontinentet sipas dendësisë së popullsisë dhe i rendit ato nga kontinenti më i dendur në kontinentin më pak të populluar (dmth. kontinenti i pabanuar); • Bën dallimin ndërmjet kontinentit me popullsinë më të dendur dhe kontinentit me popullsinë më të madhe; • Lidh dendësinë e popullsisë me shtimin natyror (natalitetin dhe mortalitetin) dhe lëvizjet migratore (migracioni dhe emigracioni) të popullsisë; • Shpjegon ndryshimet në strukturën e popullsisë së kontinenteve të ndikuar nga lëvizjet migruese të njerëzve me ngjyra të ndryshme të lëkurës dhe përkatësi fetare; • Tregon efektet pozitive të lëvizjeve migratore (kontribuon në pranimin e dallimeve racore, fetare dhe gjuhësore midis njerëzve);
<ul style="list-style-type: none"> • Shtetet më të mëdha në botë (shteti, kryeqyteti) 	<ul style="list-style-type: none"> • Bën dallimin midis madhësisë së një vendi sipas sipërfaqes dhe madhësisë së një vendi sipas numrit të popullsisë; • Tregon shtetet më të mëdha në çdo kontinent (sipas sipërfaqes dhe popullsisë) dhe i gjen ato në hartë politike; • Tregon kryeqytetet dhe qytetet më të mëdha të shteteve më të mëdha në çdo kontinent dhe i gjen ato në hartë politike;
<ul style="list-style-type: none"> • Popullsia, sipërfaqja dhe vendndodhja e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gadishulli Ballkanik, vendet fqinje) 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjen Maqedoninë e Veriut në hartën e Evropës, si shtet në Gadishullin Ballkanik; • Përshkruan Maqedoninë e Veriut sipas sipërfaqes dhe popullsisë; • Tregon vendet fqinje të Maqedonisë së Veriut dhe kryeqytetet e tyre dhe i gjen ato në hartë; • Krahason madhësinë e Maqedonisë së Veriut me madhësinë e vendeve fqinje (sipas sipërfaqes dhe popullsisë) dhe i rendit të gjitha sipas madhësisë.
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, kërkojnë në internet informacion rreth zbulimeve të mëdha gjeografike (Kristofer Kollumbo, Vasko de Gama, Fernando Magelan, Xhejms Kuk etj.) dhe diskutojnë së bashku; • Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, kërkojnë në internet informacion rreth vendeve që nuk janë fare të populluara dhe më pas diskutojnë arsyet për këtë; 	

- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, kërkojnë informacion në internet dhe njihen me karakteristikat e popullsisë së botës (lëvizja e popullsisë, nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror, dendësia e popullsisë, migrimi) dhe i diskutojnë ato;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, kërkojnë në internet informacion mbi ngjyrën e lëkurës, prejardhjet e ndryshme fetare dhe përdorimin e gjuhëve në botë dhe diskutojnë ngjashmëritë dhe dallimet;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, vizatojnë konturet e kontinenteve, i presin dhe i renditin sipas zonës që zënë duke filluar nga më i madhi. Nga burime të ndryshme ata gjejnë informacione për popullsinë dhe dendësinë e popullsisë së kontinenteve dhe i shkruajnë ato në konturet e kontinenteve dhe më pas diskutojnë të dhënat e marra;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, bëjnë një tabelë të vendeve më të mëdha në çdo kontinent me të dhëna për sipërfaqen, popullsinë dhe kryeqytetet e tyre;
- Çdo nxënës lexon hartën politike të botës dhe gjen vendet më të mëdha dhe kryeqytetet e tyre;
- Nxënësit shikojnë një raport mbi Antarktikun dhe më pas diskutojnë vendndodhjen dhe popullsinë e saj;
- Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëri grup është një "agjensi turistike" dhe tjetri është një grup "turistësh". Turistët i drejtohen agjencisë së turizmit për të organizuar një udhëtim në një vend të caktuar në një kontinent (kur grupet rrotullohen, kontinentet dhe vendet ndryshojnë). Agjencia turistike planifikon udhëtimin e tyre, tregon vendet dhe qytetet kryesore, numrin e popullsisë dhe shpjegon pse duhet t'i vizitojnë ato vende dhe qytete. Të dy grupet përdorin një hartë politike të botës për të përcaktuar destinacionet dhe për të hartuar se cilat vende dhe qytete duhet të vizitohen;

Tema: **PARAHISTORIA DHE HISTORIA**

Gjithsej: **25 orë**

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. dallojë se si e kaluara e njerëzimit ndahet në dy periudha të mëdha kohore—parahistoria dhe historia dhe të dallojë periudhat themelore brenda parahistorisë dhe historisë;
2. shpjegojë se si llogaritet koha në të kaluarën dhe si llogaritet sot;
3. të dallojë llojet elementare të burimeve historike dhe të japë shembuj për secilin prej tyre;
4. japë shembuj të objekteve të njohura arkeologjike në botë dhe në territorin e vendit tonë dhe t'i lokalizojë ato në aspektin kohor dhe hapësinor.

Nxënësi/nxënësja kupton se:

1. Vendet arkeologjike janë të rëndësishme për të kuptuar historinë e botës.

Përmbajtjet (dhe konceptet)

- Periudhat historike

Standardet për vlerësim

- Përcakton kohëzgjatjen e periudhave themelore kohore: vit, dekadë, shekull, mijëvjeçar.

<p>(periudhat kohore: viti, dekada, shekulli, mijëvjeçari, epoka; epokat historike, parahistoria: epoka e gurit, epoka e metalit; historia: historia e lashtë / antike, Mesjeta , shekulli i ri / historia moderne dhe kohët moderne / historia moderne);</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Bën dallimin midis parahistorisë dhe historisë; • Tregon karakteristikat e epokës së gurit dhe metalit dhe radhën e shfaqjes së tyre; • Tregon zbulimet kryesore të parahistorisë dhe përshkruan ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve (përdorimi i fjalës, shfaqja e zjarrit, shfaqja e metaleve, zbulimi i rrotës); • Shpjegon rolin e krijimit të shkrimit për historinë; • Tregon shkronjat e para të njohura të zbuluara (shkrimi hieroglifik në Egjipt dhe shkrimi kuneiform në Mesopotami); • Prezenton ndarjen e periudhës para erës sonë dhe periudhës së epokës sonë në një shirit kohor; • Tregon periudhat themelore historike (historia e lashtë / antike, mesjetare, shekulli i ri/ historia moderne dhe koha më e re/historia bashkëkohore) dhe i vendos ato në shiritin kohor;
<ul style="list-style-type: none"> • Llogaritja e kohës në histori (Kalendari egjiptian, kalendari asirian, kalendari islamik, kalendari hebre, kalendari julian, kalendari gregorian); 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon veçoritë themelore të llogaritjes së kohës në histori dhe jep shembuj të mënyrave të ndryshme të llogaritjes së kohës në të kaluarën; • Përshkruan mënyrën e llogaritjes së kohës sipas kalendarëve të ndryshëm të përdorur në të kaluarën në pjesë të ndryshme të botës; • Shpjegon llogaritjen e kohës sipas kalendarit gregorian;
<ul style="list-style-type: none"> • Burimet historike (burime materiale, burime të shkruara; lokalitete arkeologjike, arkiva, muzeume); 	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton llojet e burimeve historike (materiale dhe të shkruara) dhe i përshkruan ato sipas karakteristikave; • Jep shembuj për çdo lloj burimi historik; • Lidh lloje të ndryshme burimesh historike me institucionet në të cilat mbahen (arkiv, muze, bibliotekë);
<ul style="list-style-type: none"> • Vende të famshme arkeologjike në botë; • (Stonehenge, Muri i Madh i Kinës, Piramidat e Gizës, Maçu Pikçu, Çiçen Iza, Akropoli, Koloseu Romak); • Vendet arkeologjike në territorin e vendit tonë; • (Kokino, Stobi, Heraklea, Kalaja e Samoilit); 	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon dhe përshkruan vende të famshme arkeologjike në botë; • I vendos në mënyrë kohore dhe hapësinore vendet e famshme arkeologjike në botë (në një hartë gjeografike dhe në një shirit kohor); • Tregon dhe përshkruan zona të njohura arkeologjike në territorin e vendit tonë; • I vendos në mënyrë kohore dhe hapësinore vendet e njohura arkeologjike në territorin e vendit tonë (në hartë gjeografike dhe në një shirit kohor); • Gjen mbetjet e së shkuarës së afërt dhe të largët në afërsi të vendbanimit të vet.

Shembujt e aktiviteteve

- Nxënësit, të ndarë në grupe, bëjnë 10 shirita nga 1 metër secili (paraqesin një mijëvjeçar) dhe i bashkojnë me njëri-tjetrin, 1 shirit prej 1 metër, d.m.th. 100 centimetra (përfaqëson një shekull), 1 shirit prej 10 centimetrash (përfaqëson një dekadë) dhe një shirit prej 1 centimetri (përfaqëson një vit). Rregulloni shiritat në një mënyrë që të mundësojë krahasimin vizual të periudhave kohore që shfaqen. Renditni nga periudha më e gjatë në atë më të shkurtër. Përndryshe, shiritat mund të vizatohen në oborrin e shkollës. Pastaj ata diskutojnë se çfarë përbën një kohë prej dhjetë vjetësh (dekadë), njëqind vjetësh (shekull), njëmijë vjetësh (mijëvjeçar);
- Mësimdhënësi shpjegon parahistorinë si një periudhë që fillon me shfaqjen e njeriut dhe shpjegon veçoritë kryesore të parahistorisë. Më pas nxënësit, në grupe, kërkojnë në internet informacion për t'iu përgjigjur pyetjeve: *Si jetonin njerëzit në parahistori?; Pse një periudhë e caktuar e parahistorisë quhet kohë guri, dhe një periudhë e caktuar kohë metalike?; Çfarë i bëri ata të ashtuquajturat?; Cilat shpikje ndikuan në mënyrën e jetesës së njerëzve në atë kohë?* Ata ua prezantojnë informacionin të tjerëve dhe nxjerrin përfundime nëpërmjet një diskutimi të hapur;
- Nxënësit kryejnë aktivitetin “Çanta e së shkuarës”. Nga një çantë e mbyllur ata nxjerrin ilustrime të objekteve nga parahistoria dhe skena nga jeta në parahistori, në të cilat zbulimet kryesore tregohen dhe vendosen në një shirit kohorë të përgatitur paraprakisht me kohë të shënuar prej guri dhe metali;
- Mësimdhënësi nëpërmjet një prezantimi vizual tregon se si duken dhe në çfarë hapësire janë gjetur artefaktet e para të shkruara. Nxënësit (të ndarë në grupe) marrin një fletë pune me shenja nga një nga shkronjat e vjetra me kuptimin e tyre. Detyra e tyre është të kopjojnë disa prej tyre në një copë letre të madhe dhe, nëse është e mundur, t'i grupojnë si në një "fjalë". Secili grup paraqet “fjalitë” e shkruara dhe interpreton kuptimin e tyre. Bëhet një diskutim nëpërmjet të cilit nxënësit perceptojnë kuptimin e shkrimit dhe mundësinë që ajo që do të shkruhet t'u kalojë brezave të tjerë. Në fund, arrihet në përfundimin se periudha nga zhvillimi i njerëzimit deri në shfaqjen e shkrimit (periudhë për të cilën nuk ka dokumente të shkruara) quhet parahistori, dhe periudha nga shfaqja e shkrimit deri më sot quhet histori;
- Mësimdhënësi vizaton në tabelë një shirit kohor që tregon periudhat e historisë (shekulli i vjetër, i mesëm dhe i ri), duke përfshirë kufirin midis periudhës para erës sonë dhe periudhës së epokës sonë. Nxënësit, të ndarë në grupe, kryejnë aktivitetin veprimtarinë “Çanta e së shkuarës” në të cilin paraprakisht vendosen: 1) foto të personazheve të famshëm të periudhave të ndryshme historike me emrat dhe vitet e jetës së tyre (p.sh.: Kleopatra, Aleksandri i Madh, Aristoteli, Nikolla Koperniku, Marko Polo, Skënderbeu, Katerina e Madhe, Mbretëresha Viktoria, Goce Delçevi), 2) ilustrime të ngjarjeve të famshme nga periudha të ndryshme të historisë me emrat e tyre dhe vitet kur kanë ndodhur (shembull: ndërtimi i Via Egnatia, shkatërrimi i Pompesë, shpërngulja e sllavëve, mbretëria e Samoilit, kryqëzatat, murtaja e madhe në Evropë, Revolucioni i Parë Industrial, zbulimi i Amerikës) dhe 3) harta ose simbole që përshkruajnë qytetërimi, mbretëri ose qytet-shtete të lashta me emra dhe vite ekzistence (shembull: Mesopotamia, Kartagjena, Perandoria Romake, Bizanti, Venecia). Çdo ilustrim, përveç titullit dhe vitit/ve, pasohet nga një tekst i shkurtër (1 deri në 2 fjali). Secili grup në mënyrë alternative tërheq një nga ilustrimet nga çanta dhe e vendos atë në shiritin kohor. Në fund thuhet bashkërisht se çfarë ndodhet në secilën nga tre periudhat;

- Nxënësit gjejnë në një hartë konceptuale periudhat e parahistorisë dhe historisë;
- Mësimdhënësi, nëpërmjet një prezantimi vizual, shpjegon se cili është kalendari në të cilin tregohet viti aktual. Nxënësit marrin një kalendar të shkruar ose përdorin një kalendar elektronik për të përcaktuar se si janë organizuar ditët, javët dhe muajt brenda vitit për të cilin zbatohet kalendari. Nxënësit diskutojnë se për çfarë përdoret kalendari në jetën e përditshme për të arritur në përfundimin se kalendari është një sistem për të shfaqur kohën për qëllime të ndryshme (për të përcaktuar se cilat ditë janë ditë pune, cilat janë fundjavë dhe pushime, për të planifikuar punën, kohën e lirë, etj.). Më pas mësimdhënësi prezanton nocionin e kalendarit si një mjet për llogaritjen e kohës duke vënë në dukje se mënyra se si llogaritet dhe shfaqet koha sot është e ndryshme nga ajo se si ishte në të kaluarën.
- Nxënësve të ndarë në grupe u jepet detyrë të hulumtojnë se si llogaritet koha (kur ka filluar viti, sa muaj ka pasur, sa javë dhe ditë, kur kanë filluar etj.) sipas kalendarit egjiptian, asirian, islame, hebrej dhe julianë (një për secilin grup). Secili grup përgatit një prezantim multimedial në të cilin, përveç se tregon se kur është krijuar dhe përdorur kalendari që kanë hulumtuar, ai e krahason atë me kalendarin zyrtar që përdoret sot (p.sh.: sipas mënyrës së përcaktimit të vitit, sa zgjat viti, periudhat kohore që e përcaktojnë atë). etj.). Pas prezantimeve nga të gjitha grupet, nëpërmjet diskutimit, perceptohet diferenca mes kalendarëve të vjetër dhe konkludohet në bazë të së cilës është llogaritur koha në të kaluarën (lëvizja e Diellit, Hënës, yjeve/planeteve);
- Mësimdhënësi, nëpërmjet një prezantimi vizual, shpjegon se kur dhe pse përdoret kalendari gregorian, i cili përdoret sot në të gjithë botën në paraqitjen zyrtare të kohës. Diskutimi përmbledh ndryshimet midis kalendarëve të vjetër dhe kalendarit gregorian. Më pas nxënësit, të ndarë në grupe, hulumtojnë se për çfarë qëllimesh përdoren ende kalendarët julian, islamik dhe hebre në vendin tonë. Pas prezantimeve të tyre, bashkërisht konkludohet roli i kalendarëve të vjetër në përcaktimin e festave fetare;
- Mësimdhënësi shpjegon se historia mësohet nëpërmjet të dhënave nga e kaluara nga burime të ndryshme që mund të jenë materiale dhe të shkruara. Nxënësit përdorin telefona celularë për t'iu përgjigjur pyetjeve duke përdorur një mentometër - për çdo ilustrim që u tregon mësimdhënësi (për shembull: një hartë historike; një fotografi e një personi ose ngjarje nga e kaluara; një gërmim arkeologjik, si një monedhë ose objekt tjetër; një letër ose një dokument tjetër nga e kaluara; një ditar që përshkruan një ngjarje nga e kaluara ose jeta e një personi të famshëm), secili nxënës individualisht (ose secili grup veç e veç, nëse ndahet në grupe) përcakton nëse ilustrimi i dhënë tregon një material ose burim të shkruar. Pas çdo ilustrimi shpjegohet përgjigjja e saktë dhe komentohen grafikët mbi të cilët paraqiten përgjigjet e nxënësve. Në fund nxënësit bëjnë përmbledhje - grupojnë shembujt e dhënë në dy llojet e burimeve dhe japin shembuj të tjerë për secilin lloj;
- Mësuesi, nëpërmjet një prezantimi vizual, prezanton para nxënësve institucionet në të cilat mbahen burimet historike: muzeu arkeologjik. (https://mdz.matterport.com/shoni/?m=1zAecDjfadcdj&utm_source=4; <http://tours.rcku.org.mk/eu/Muzej-Kumanovo/>; <https://www.google.co.uk/maps/|51.5192048,-0.1274951,2a,75y,172.87h,89.26t/data=!3m6!1e1!3m4!1sFyBuFtvu6FeVvVvc5--uiw!2e0!7i13312!8i6656?hl=en>), arkivi (<https://arhiv.mk/>; <https://njinj.nationalarchives.gov.uk/museum/>) dhe biblioteka (<http://nubsk.edu.mk>; ...). Gjatë shikimit të prezantimeve, nxënësit shkruajnë në një fletë përpara se çfarë lloj burimesh kanë identifikuar në

secilin prej institucioneve të paraqitura. Së fundi, ato lidhin së bashku llojet e ndryshme të burimeve historike me institucionet në të cilat ato mbahen;

- Mësimdhënësi përdor prezantime vizuale për vendet arkeologjike të mëposhtme: Stounhexh (<https://www.englishheritage.org.uk/visit/places/stonehenge/history-and-stories/stonehenge360/>), Muri Kinez (<https://www.youtube.com/watch?v=WXlff7TN1QQ>), piramidat në Giza (<https://www.mentalfloss.com/article/645564/take-virtual-tour-pyramids-giza>), Maçu Pikçu (<https://www.youvisit.com/tour/machupicchu>), Çiçen Ica (<https://www.airpano.com/360photo/chichen-itza-mexico/>), Akropoli (<https://www.acropolisvirtualtour.gr/>) dhe Koloseumi Romak (<https://historyview.org/library/roman-colosseum/>). Nxënësit fillimisht shohin çdo vendndodhje individuale nëpërmjet një turneu virtual. Më pas, në grupe, ata përshkruajnë atë që panë dhe e ndajnë atë me të gjithë, dhe mësuesi tregon rëndësinë e vetë faqes. Më pas, nxënësit në të njëjtat grupe hulumtojnë vetë se kush e ka ndërtuar, ku ndodhet dhe nga ka ardhur dhe ua prezantojnë gjetjet të gjithëve. E njëjta procedurë përsëritet për çdo vend veç e veç. Në fund, çdo faqe është e vendosur në një hartë dhe në një shirit kohor;
- Mësimdhënësi përdor prezantime vizuale për këto zona arkeologjike në vendin tonë: Kokino (<http://tours.rcku.org.mk/eu/Kokino/>), Stobi (<https://macedoniafromabove.mk/stobi/>), Heraklea (<https://bitola.info/heraclea-lyncestis-bitola/>), Kalaja e Samolilit (<http://macedoniafromabove.mk/ohrid/index.htm>). Nxënësit fillimisht shohin çdo vendndodhje individuale nëpërmjet një turneu virtual. Më pas, në grupe, ata përshkruajnë atë që panë dhe e ndajnë atë me të gjithë, dhe mësimdhënësi tregon rëndësinë e vetë faqes. Më pas, nxënësit në të njëjtat grupe hulumtojnë se ku janë dhe nga vijnë dhe ua prezantojnë gjetjet të gjithëve. E njëjta procedurë përsëritet për çdo vend veç e veç. Në fund, çdo faqe është e vendosur në një hartë dhe në një shirit kohor;
- Nxënësit, të ndarë në grupe, përgatisin prezantime multimediale të burimeve historike vizuale nga e kaluara e afërt dhe e largët në afërsi të vendbanimit të tyre. Në prezantim mund të përfshihen edhe burime gojore - kujtime të banorëve të moshuar në mbështetje të burimeve pamore nga e kaluara e afërt. Secili grup prezanton atë që përgatitet para të tjerëve.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, NDËRKULTURA DHE INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi e siguron gjithëpërfshirjen duke i kyçur të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës. Në këtë mënyrë, ai mundëson që çdo fëmijë të jetë i angazhuar në mënyrë konjitive dhe emocionale nëpërmjet përdorimit të qasjeve të përshtatshme në mësimdhënie (individualizimi, diferencimi, puna në ekip, mbështetja mes nxënësve). Gjatë punës me nxënësit me aftësi të kufizuara, zbatohet një plan arsimor individual (me rezultate të përshtatura të mësimi dhe standarde të vlerësimit) dhe çdo herë kur është e mundur përdoret mbështetje shtesë nga individë të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat e qendrave të burimeve).

Vëzhgon rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata të grupeve të ndjeshme, në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë vështirësitë e të mësuarit në kohën e duhur, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata në arritjen e rezultateve në mësimnxënie.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimitdhënësi trajton si djemtë ashtu edhe vajzat në mënyrë të barabartë, duke u kujdesur që të mos u caktojë atyre role stereotipike gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, bën përpjekje për të siguruar ekuilibrin gjinor. Kur zgjedh materiale shtesë në mësimdhënie, përdor ilustrime dhe shembuj që janë të ndjeshëm në aspekt gjinor dhe etnik/kulturor dhe inkurajon barazinë gjinore, gjegjësisht promovon ndërkulturën.

Çdo herë kur është e mundur, mësimitdhënësi përdor integrimin e temave/ përmbajtjeve/koncepteve gjatë planifikimit dhe zbatimit të mësimdhënies. Integrimi mundëson nxënësit të përfshijnë perspektivat e lëndëve të tjera mësimore në atë që mësojnë në këtë lëndë dhe të lidhin njohuritë nga fusha të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'iu mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimitdhënësi vazhdimisht ndjek aktivitetet e tyre gjatë mësimdhënies dhe të mësuarit, gjithashtu mbledh informacione për përparimin e secilit nxënës. Informacioni kthyes gojor jepet vazhdimisht dhe tregon nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit/detyrës dhe jep drejtime për përmirësim (vlerësim formativ). Ky komponent është pjesë integrale e planifikimit të mësimitdhënësve për mësimitdhënien dhe të mësuarit. Për këtë qëllim, mësimitdhënësi vëzhgon dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimitdhënësi ose shokët/ shoqet e klasës;
- kontributi në aktivitetet grupore;
- pjesëmarrja në hulumtime;
- punimi i projekteve;
- përgjigjet e kuizeve që janë pjesë e mësimdhënies;
- kontributin në nxjerrjen e konkluzioneve;
- fletoret e punës;
- detyrat e shtëpisë;
- performanca praktike lidhur me standardet për vlerësim.

Pas përfundimit të mësimit të secilës temë, nxënësit marrin një notë përmblledhëse në formën e përshkrimit të standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi përmblledhës rrjedh nga progresi i bërë nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr një notë përmblledhëse numerike.

Fillimi i implementimit të programit mësues	Viti 2022/2023
Institucioni/përfaqësues i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
<p>Në pajtim me nenin 30 paragrafi (3) të Ligjit të Arsimit Fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 161/19 dhe 229/20) Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësues për lëndën <i>Histori dhe shoqëri</i> për klasën e V.</p>	<p>Vendimi nr. _____ Data _____</p> <p style="text-align: right;">Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës Milla Carovska</p> <p style="text-align: right;">_____</p>